



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER SOKOL SH. MALAJ  
ADRESA NR.2, LUIGJ GURAKUQI  
TEL: 684055554



## VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

Nr. repertori: 733

Tirane më 29/03/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2023050710040959197

**STATUTI I SHOQËRISË TREGËTARE  
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"LIVING WITH THE LAND" Sh. P. K**

Në Tiranë më datë 29 Mars 2023 (dymjë e njëzet e tre) ditën e mërkurë, unë i nënshkruari **Z.ILIR SULAJ** i biri i Flamur, dhe Ditur, shtetas Shqiptar, lindur në Panahor dhe banues në Tiranë, DËSHMORËT E 4 SHKURTIT; Nd. 15; H. 14; Ap. 8; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, lindur më 28/02/1982, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me Leternjoftim ID 035707942 dhe nr. personal I20228158N,— *me cilësinë e ortakut të vetëm dhe, me vullnetin tim të lirë e të plotë vendosa të krijoj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "LIVING WITH THE LAND" Sh. P. K.* me sëli në Tiranë.—

**Neni 1**

**EMËRTIMI DHE QENDRA E SHOQËRISË**

**EMËRTIMI : "LIVING WITH THE LAND" Sh. P. K**

**SELIA:** Rruga "Ullishtes", Ndërtesa Nr 9, Hyrja 4, Apt 10, Tiranë, Shqipëri

Shoqëria do të jetë person juridik me regjistrimin në QKB sipas nenit 22 të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" e në bazë të Ligjit Nr 9901 të datës 14.04.2008 "PËR TREGËTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE". Shoqëria do të gjëzojë të gjithë të drejtat si peson juridik dhe do të fillojë veprimtarinë e saj nga data e regjistrimit në Q.K.B.—

**Neni 2**

**QËLLIMI I SHOQËRISË**

*Objekti i Shoqërisë do të jetë:*

- Prodhim, grumbullim, përpunim, paketim, eksport-import, tregëtim me shumicë dhe pakicë i bimëve medicinale, produkteve ushqimore, dhe blegtore.
- Transport mallrash dhe pasagjerësh.
- Kërkim dhe zbulim tregjesh.
- Konsulencia të ndryshme mbi aktivitetet tregtare.
- Ndërmjetësim mes Kompanish të ndryshme dhe në fusha të ndryshme bashkëpunimi
- Tregëtimi me shumicë dhe me pakicë i mallrave ushqimore, industriale, elektrike, elektroshtëpiake, konfeksione, paisje elektroshtëpiake, pjesë këmbimi etj.
- Importimi dhe eksportimi i produkteve me shumicë i mallrave ushqimore të të gjitha llojeve, atyre industriale etj.



- Importimi, eksportimi i produkteve te gatshme dhe gjysëm të gatshme si dhe i lëndëve të para për to si dhe kontraktimi me persona të ndryshmë fizike apo juridike, vendas apo të huaj për këtë qëllim,
- Blerje, shitje, dhënje me qira të pasurive të luajtëshme dhe të paluajtëshme.
- Eksport dhe/ose import i të gjitha prodhimeve të mësipërme, si dhe shitblerje, me shumicë dhe pakicë; edhe OnLine; magazinim dhe shpërndarje/distribuim.
- Hapje e pikave të shitjes me shumicë dhe pakicë për këtë qëllim në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë tij.
- Prodhimi dhe tregëtimi me shumicë dhe pakicë i materialeve të ndërtimit, import, eksport i tyre, brenda dhe jashtë vendit për llogari të vetë shoqërisë si dhe të të trëtëve, ku përfshihen interte, rërë, granile të fraksioneve të ndryshme si dhe çdo material tjetër që nuk është përmendur këtu por përdoret për ndërtim.
- Gjithashtu për të realizuar objektin dhe qëllimet e saj, Shoqëria mund të ndërmarrë dhe të zhvillojë çdo lloj aktiviteti lidhur me shitblerjen e pasurive të luajtëshme dhe të paluajtëshme, si edhe çdo lloj aktiviteti tregtar, financiar, qiradhënës apo dorëzënës, që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj.

*Ky aktivitet do të zhvillohet në fushën internacionale dhe në atë nationale“.*

### Neni 3

#### **REGJIMI JURIDIK I SHOQËRISË**

“Shoqëria”, në veprimtarinë e saj bazohet në legjislacionin e Republikës së Shqiperisë. Kjo shoqëri tregëtare krijohet me objektivin për të vazhduar veprimtarinë për një periudhë kohore pa afat.—

Me vendim të “Asamblesë së Përgjithshme”, mund të ndryshojë rregjimin juridik të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas Legjislacionit Shqiptar. Në këtë rast “Ortaku” do ta përshtasë “Statutin e Shoqërisë”, si dhe regjistrimin e tyre nga organet kompetente Shqiptare.

“Shoqëria” gezon personalitet juridik nga dita e miratimit dhe e regjistrimit të saj në regjistrin tregëtar në Q.K.B.—

“Shoqëria” mund të ketë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, në përputhje me dispozitat e Legjislacionit Shqipëtar. Pasuria mbrohet sipas dispozitave të ligjit në fuqi.—



#### Neni 4

#### KAPITALI THEMELTAR

Për të siguruar funksionimin fillestare të Shoqërisë, "Ortaku i vetëm" formon kapitalin fillestare të shoqërisë prej **10.000 Lekë** (dhjetë mijë), me një kuotë të vetme me vlerë nominale **10.000 Lekë** (dhjetë mijë) kuota.—

Shtesa e kapitalit themeltar, vendoset me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Kapitali themeltar mund të shtohet në vartësi të aktivitetit, nga kontributet plotësuese të ORTAKËVE (*në rast ndryshimi/shtimi të Ortakëve*), sipas përqindjes së tyre në këtë kapital, me përjashtim të rasteve kur vendoset unanimisht e kundërta.—



Kapitali i shoqërisë i kontribuar nga çdo ortak do të regjistrohet në librin e regjistrimit të kapitalit të shoqërisë.—

#### Neni 5

#### TRANSFERIMI I KUOTAVE

Në përputhje me ligjin "**PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE**" pjesët e kapitalit themeltar janë lehtësish të transferueshme. Në përputhje me Ligjin e cituar me sipër pjesët e kapitalit themeltar mund t'i kalojnë personave të tretë jashtë shoqërisë, pasi është vendosur nga Asambleja e Përgjithshme.—

Ortaku ka të drejtën e parablerjes së pjesëve të kapitalit themeltar, ndaj njëri-tjetrit. Ortakët duhet të informohen për planin e transferimin të pjesëve të kapitalit themeltar.

Nëse shoqëria nuk njofton vendimin e saj brenda dy muajve nga data e marjes se informacionit, transferimi quhet i aprovuar, nëse shoqëria refuzon aprovimin e transferimit brenda dy muajve nga ky refuzim ortakët duhet ta blejnë vetë ose t'u lejojnë palëve të treta të blejnë pjesën e kapitalit themeltar sipas rregullave të përcaktuara në Ligjin "Mbi Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

#### Neni 6

#### ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Shoqëria administrohet nga **ZILIR SULAJ** i cili ka të drejtën të veprojë me këtë cilësi për një periudhe 5-vjeçare nga data e regjistrimit në QKB. Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në marrëhenie me të tretët përmblushjen e aktivitetit të saj në përputhje me nenin 9 të këtij statuti.—

#### Neni 7

#### KOMPETENCAT E ASAMBLESË SË ORTAKËVE

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme mund të vendoset ndryshimi i Statutit të Shoqërisë si dhe të përqindjes së pjesëmarrjes së "Ortakëve".

- Përcaktimi i synimeve që do të ketë Shoqëria.-
- Miratimi i rezultateve vjetore të Shoqërisë dhe raportin vjetor të auditimit.
- Riorganizimi dhe shkrirja, ose mbyllja e Shoqërisë.



- Zgjedhja e administratorëve të Shoqërisë.
- Miratimi i raportit vjetor të punës së kryer nga Administratori.
- Administrimi i pasurisë së Shoqërisë.
- Miratimi i çdo lloj garancie të ofruar nga Shoqëria (Hipotekë, pengu) në formën e së drejtës se posedimit të pasurisë së Shoqërisë si dhe garancive të tjera që kanë të bëjnë me borxhet e Shoqërisë në bazë të Legjislacionit në fuqi.
- Miraton buxhetin e shpenzimeve rrjedhëse, dhe raporte të tjera ekonomike që parashikon ligji.
- Përcakton ndarjen në pjesë të fitimit dhe mënyrën e përdorimit të fitimit.
- Emërimin dhe shkarkimin nga detyra të Administratorit.
- Emërimin dhe shkarkimin nga detyra të ekspörteve kontabël.

#### **Neni 8 MBLEDHJA VJETORE**

Shoqëria organizon të paktën një herë në vit mbledhjen e Asamblesë për të analizuar aktivitetin e Shoqërisë. Mbledhjen e përgjithshme e kryeson Administratori i shoqërisë.

#### **Neni 9 ADMINISTRATORI**

Ortaku i vetëm vendos që Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë të jetë **Z. ILIR SULAJ.**—

Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë, mund të kryejë të gjitha veprimet ligjore që janë në interes të shoqërisë në përputhje me Statutin e Aktin e Themelimit te saj.

Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë, do të ketë autoritet të përgjithshëm në aktivitetin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe ka të drejtë e marrjes se çdo ndërmarrje dhe çdo veprimi që konsiderohet i nevojshëm për realizimin e qëllimit të shoqërisë me përjashtim të rasteve që ligji “Mbi Tregëtaret dhe Shoqëritë Tregëtare” i kufizon. Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë, ka të drejtë t’i propozojë mbledhjes së Asamblee së Ortakëve (në rast ndryshimi/shtimi të Ortakëve) planin e mbledhjeve duke marrë vendime për zhvillimin e veprimitarive të shoqërisë, duke përcaktuar dhe linjat kryesore të veprimitarise së shoqërisë.

Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë, ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët për përbushjen e aktivitetit te saj në perputhje me parashikimet në statutin e kësaj shoqerie.

Organi Administrativ (Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë.) është kompetent për të:

- realizuar mbledhjen e Asamblesë duke njofuar (ortakët kur ka) me shkrim ose via email, 15 ditë me parë;
- miratuar planet dhe bilancet periodike mujore dhe tre mujore;

- propozuar strukturën e aparatit të shoqerisë;
- Te marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdheneve të punës me ta;
- propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme (të vecanta), ndarjen e fitimit, etj.
- përfaqësuar apo emëruar përfaqësues në çështje gjyqësore që mund të ketë shoqëria;
- emëruar përfaqësues duke i deleguar të gjitha ose një pjesë të kompetencave të tij.

**Neni 10  
LLOGARIA E SHOQËRISË**

“Shoqëria” hap llogaritë e veta në Lekë dhe në valutë, të cilat funksionojnë sipas legjislacionit  
në fuqi.

**Neni 11  
VITI EKONOMIK**

Viti ekonomik fillon më 01.Janar dhe mbaron më 31. Dhjetor të vitit kalendarik. Me mbarimin e periudhes ushtrimore shoqëria harton pasqyrat financiare të cilat pasi auditohen nga eksperti kontabel i regjistruar (i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme) së bashku me raportin e këtij të fundit i paraqiten për aprosim Asamblesë së Përgjithshme deri më 30 Qershori të vitit që pason vitin e mbyllur ushtrimor.—

**Neni 12  
LLOGARIA EKONOMIKE**

“Shoqëria” funksionon mbi bazën e udhëzimeve të veçanta dhe të planeve që janë miratuar nga Administratori i përgjithshëm. Mban në mënyrë të pavarur librat e saj kontabël dhe situacionet.Kontrolli i përgjithshëm kontabël dhe statistikor bëhet mbi bazën e dispozitave ligjore që veprojnë në Shqipëri.

Libri kontabël mbahet në Gjuhën Shqipe në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Brenda tre muajve nga mbarimi i vitit ekonomik bëhet bilanci dhe nxirren përfundimet e veprimtarisë të vitit të kaluar (*fitimet ,humbjet* ).

Me qëllim që të ushtrojë të drejtën e kontrollit, ortaku i vetëm ka të drejte të marrë informata dhe të kontrollojë çdo çështje që i takon veprimtarisë dhe administrimit pasuror të saj edhe gjatë periudhës ushtrimore.—

**Neni 13  
KONTROLLI KONTABËL**

“Shoqëria” mban librat kontabile për të regjistruar të gjitha veprimet e saj në bazë të udhëzimeve të përgjithshme kontabile që veprojnë në Shqipëri.

Librat kontabël kontrollohen çdo vit nga ekspertet kontabël.—

**Neni 14**  
**NDARJA E FITIMEVE**  
Fitimet e Shoqërisë janë pronë e ortakut të vetëm (Ortakëve).—

**Neni 15**  
**RASTET E NDËRPRERJES DHE PRISHJES**  
**TË VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**  
"Ortaku" ka të drejtë të ndërpresë marrëdhieniet që rrjedhin nga kontrata e krijuarit dhe statutit kur vërtetohen arsyet serioze që vijojnë:

Kur veprimtaria ekonomike nuk sjell fitim.

Kur vërtetohen kushtet e forcës madhore që parashikon ligji.

Varfërimi i "Shoqërisë",

Dalja e një Vendimi nga organet kompetente që ndalon veprimtarinë e "Shoqërisë" në qoftë se një funksionim i tillë vjen ndesh me ligjin dhe gjatë kohës që vepron vendimi. Marrja e vendimit unanim merret nga Ortaku i vetëm.—

Gjithashtu Shoqëria prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me vendim të ortakut të vetëm / apo ortakëve,
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) me vendim gjykatë;

d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk ka njoftuar pezullimin e veprimtarisë, sipas pikës 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"

**Neni 16**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**  
Çështjet e pa mbuluara nga ky statut do te rregullohen nga legjislacioni Shqipetar dhe ne veçanti nga Ligji Nr.9901 dt 14.04.2008 „Mbi Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare“.—

**Neni 17**  
**HYRJA NË FUQI**  
Ky Statut i pranuar nga "Ortaku i vetëm" hyn në fuqi momenti i nënshkrimit në prani të Noterit në vendin dhe datën që përmendet në akt dhe me regjistrimin në QKB.

U hartua në tre kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETËM  
"LIVING WITH THE LAND" Sh. P. K.  
Përfaqësuar nga Z. ILIR SULAJ

